

PROJEKT-MARREVESHJE DHE RAPORTI PER BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE

“Fondi Erpa” sh.p.k dhe “Erpa Investment ” sh.p.k.

Kjo projekt-marreveshje dhe Raport Bashkimi lidhet sot, me date 30.07.2018 ne Tirane, ndermjet paleve te meposhtme:

1. SHOQERISE “Fondi Erpa” Sh.p.k. person juridik i organizuar dhe qe vepron ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, me seli ne Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, Pallati 11/1, EGT Tower, Kati 5, Tirane, e regjistruar prane QKB, me NIPT L51308018A, perfaqesuar nga Administratori Z. Paulin Rranzi, ketu e me poshte **Shoqeria Perthithese;**

dhe

2. SHOQERISE “Erpa Investment ” sh.p.k., person juridik i organizuar dhe qe vepron ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, me seli ne Njesia bashkiake nr 5, rruga Abdyl Frasheri, pallati 11/1, EGT Tower, kati 5, Tirane, e regjistruar prane QKB , me NIPT L12025001L, perfaqesuar nga Administratori Z. Paulin Rranzi ketu e me poshte si **Shoqeria e Perthithur.**

Palet bien dakord per sa me poshte:

1. PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Ne kete projekt-marreveshjedhe Raport bashkimi(duke perfshire edhe anekset bashkelidhur), pervec rasteve kur kerkohet ndryshe nga konteksti ose percaktohet ndryshe ne vazhdim, fjalet e renditura me poshte kane keto kuptime:

“Projekt-Marreveshja”-dote thote kjo Projekt-marreveshje dhe Raport Bashkimi me Perthithje- duke perfshire si pjese integrale te saj edhe anekset bashkengjitur kesaj projekt-marreveshjeje, te cilat jane nenshkuar dhe shkembyer ndermjet “Fondi Erpa” sh.p.k dhe “Erpa Investment ” sh.p.k.



"Mbyllja" do te thote pranimi i te gjitha kushteve te projekt-marreveshjes se bashkimit dhe nenshkrimi e miratimi i kesaj te fundit nga Asamblete e Aksionereve te dy shoqerive te perfshira ne procesin e bashkimit.

"Data e Mbylljes" do te thote data ne te cilen do te kryhet mbyllja, pra dhe bashkimi me perthithje I tedy shoqerive.

"Ligji Tregtar" do te thote ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

"Data e Ekzekutimit" do te thote data e regjistrimit te mbylljes ne Regjistrin Tregtar prane QKB.

"Kodi i Punes" do te thote Ligji Nr. 7961 date 12.07.1995 "Kodi i punes se Republikes se Shqiperise ", i ndryshuar.

"Data e Fundit Kontabel" do te thote data 01.01.2018 ne rast se Bashkimi me Perthithje aprovet nga asamblete e shoqerive.

"Regjistri Tregtar" do te thote Regjistri Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit (QKB).

"Periudha Tranzitore" do te thote periudha kohore nga data e nenshkrimet te kesaj projekt-marreveshje (data e mbylljes) deri ne regjistrimin ne QKB te transaksionit te bashkimit me perthithje (data e ekzekutimit), gjate se ciles **"Fondi Erpa" sh.p.k** dhe **"Erpa Investment" sh.p.k.** do te kryejne nje teresi veprimesh me qellim permbyshjen e transaksionit te bashkimit me perthithje.

"Aktivet dhe Pasivet e Transferuara" do te thotete gjitha aktivet dhe pasivet e transferuara nga shoqeria e perthithur (**"Erpa Investment" sh.p.k.**) drejt Shoqerise Perthithese (**"Fondi Erpa" sh.p.k.**), sic eshte pershkruar ne kete projekt-marreveshje.

"Balanci i celjes" do te thote bilanci i shoqerise perthithese (**"Fondi Erpa" sh.p.k.**) pas konsolidimit te bilanceve te shoqerive ne Daten e Fundit Kontabel dhe pasqyrimet ne te cdo ndryshimi te mundshem te ndodhur mes Dates se Fundit Kontabel dhe dates se Mbylljes se bashkimit me perthithje.

Cdo dokument bashkelidhur kesaj projekt-marreveshjeje, duke perfshire Anekset, perben pjese integrale te kesaj projekt-marreveshjeje dhe ka te njejten fuqi ligjore dhe efekt si kjo projekt-marreveshje.

Jack
FONDI ERPA sh.p.k.
NNT: E 1513000174



2. OBJEKTI I PROJEKT-MARREVESHJES

Objekti i kesaj projekt-marreveshje eshte bashkimi nepermjet perthithjes i shoqerise “Fondi Erpa” sh.p.k dhe “Erpa Investment ” sh.p.k.

“Erpa Investment ” sh.p.k (shoqeria e perthithur) do te perthithet nga “Fondi Erpa” Sh.p.k(shoqeria perthithese) sipas kushteve te kesaj projekt-marreveshjeje. Kjo projekt-marreveshje hartohet ne perputhje me nenin 215, i Ligjit Tregtar.

Aktualisht, shoqeria perthithese “Fondi Erpa” Sh.p.k.ka si qellim grupimin e forcave dhe e mjeteve ne funksion te zgjerimit te aktivitetit. Sipas parashikimeve dhe ne perputhje me nenin 215, pika 1 -Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëjës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

Bazuar ne nenin 220, paragrafi 3 te Ligjit Tregtar, pas regjistrimit te bashkimit ne QKB ekzistenca e “Erpa Investment ” sh.p.k. si nje shoqeri e vecante do te vleresohet e prishur dhe “Fondi Erpa” Sh.p.k.do te jete shoqeria perthithese, e cila do te vazhdoje te ekzistojte me emrin “Fondi Erpa” Sh.p.k. dhe me te njejtin NIPT L51308018A.

Kjo projekt-marreveshje hartohet ne perputhje me zbatim te vendimeve te asambleve te aksionereve te te dy shoqerive pale. Keto vendime jane ne aneks te kesaj projekt-marreveshje.

3. BILANCET NE MBYLLJE DHE BILANCI I CELJES SE BASHKIMIT ME PERTHITHJE

Bashkimi me perthithje do te bazohet ne pasqyrat financiare te “Fondi Erpa” Sh.p.k.dhe “Erpa Investment ” sh.p.k. te dates *31 Dhjetor 2017*(Data e Fundit Kontabel).

Bilanci i Celjes se Shoqerise Perthithese (“FONDI ERPA” Sh.p.k.) do te bazohet ne bilancin e konsoliduar te Dates se Fundit Kontabel te te dy shoqerive perpara perthithjes. Cdo ndryshim, sakesim dhe korrigjim i mundshem i Bilancit te Celjes i realizuar mes *Dates se Fundit Kontabel* dhe *Dates se mbylljes se bashkimit me perthithje*duhet te raportohet dhe miratohet nga asamblete e aksionereve te te dy shoqerive.

Pasqyrat e pozicionit financiar te te dy shoqerive si ne daten se fundit kontabel paraqiten ne aneks te kesaj projekt-marreveshje.


FONDI ERPA Sh.p.k.
NIPT L51308018A



4. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUARA

Ne baze te nenit 215, pikal e Ligjit Tregtar, shoqeria "Erpa Investment" sh.p.k. do t'i transferoje Shoqerise perthithese "Fondi Erpa" sh.p.k., kundrejt aksioneve te kesaj te fundit, te gjitha aktivet dhe pasivet sipas Bilancit te Dates se Fundit Kontabel, duke marre ne konsiderate edhe cdo ndryshim te ndodhur deri ne daten e mbylljes se bashkimit me perthithje.

Aktivet dhe pasivet perfshijne cdo te drejte dhe detyrim te njohur si te tille ne pasqyrat financiare, bazen e te dhenave te klienteve, ne daten e ekzekutimit te mbylljes, dhe cdo marredhenie tjeter kontraktore. Aktivet dhe detyrimet tatimore te "Erpa Investment" sh.p.k.(shoqeria e perthithur), sic rezultojne ne pasqyrat financiare te dates se fundit kontabel, do ti transferohen "Fondi Erpa" Sh.p.k.(shoqeri perthithese) si te gjitha llojet e tjera te aktiveve dhe detyrimeve.

Me transferimin e aktiveve dhe detyrimeve, "Fondi Erpa" Sh.p.k. do te marre ne posedim te gjithe evidencat, librat, korrespondencat, regjistrimet, projekt-marreveshjet dhe dokumenta te tjere per te provuar ekzistencen e te drejtave dhe detyrimeve qe transferohen.


Per aktive/detyrime te caktuara per transferimin e te cilave mund te nevojitet miratimi i nje pale te trete, do te merret paraprakisht ky miratim.

Vetekuptionet se me transferimin e te gjitha te drejtave, aktiveve dhe detyrimeve te shoqerise se perthithur tek shoqeria perthithese, kjo e fundit do te gezoje te drejtat per te ngritur pretendime ligjore ndaj ketyre aktiveve si dhe do te mbart detyrimin per t'u pergjigjur ndaj pretendimeve qe mund te ngrene pale te treta per detyrime te shoqerise se perthithur.

5. RAPORTI I KEMBIMIT TE KUOTAVE

Per shkak te natyres se transaksionit, mungeses se te dhenave te besueshme te riskut te tregut te kapitaleve ne Shqiperi dhe mungeses se referencave per transaksione te ngjashme ne treg, metoda me e pershtatshme per kalkulimin e raportit te kembimit te kuotave te shoqerive te perfshira ne bashkim eshte metoda e Vleres Neto ose ndryshe Vlera Kontabel. Raporti i kembimit te Kuotave percaktohet nga madhesia e perftuar nga pjestimi i vlerave kontabel te Kuotave te dy shoqerive.

Jah
FONDI ERPA
NPT: 5130010 A



	Orataket e dy shoqerive	% e reja	Kapitali
1	EMANUELE BELLANI	1.46%	8,556,096
2	PAULIN RRANZI	48.19%	282,552,498
3	PAOLO DATTI	1.46%	8,556,096
4	GIANCARLO FIORANI	2.58%	15,098,994
5	MECAMIDI ITALIA	1.46%	8,556,096
6	PARIEL INVEST S.A	30.69%	179,980,002
7	NOLDEM srl	14.17%	83,059,982
	Totali	100.00%	586,359,764

6. KUSHTET E EKZEKUTIMIT TE BASHKIMIT

Perfundimi i plote i transaksionit te perthithjes i nenshtrohet permbushjes se kushteve te meposhtme perpara ekzekutimit:

- Asamblete e Ortakeve te shoqerive “Fondi Erpa” Sh.p.k. dhe “Erpa Investment” sh.p.k. duhet te kene miratuar kete projekt-marreveshje dhe dokumentet e tjera ne lidhje me te, ne perputhje me Nenin 218 te Ligjit tregtar.

7. EFEKTET MBI PUNEMARRESIT

Ne daten e regjistrimi te bashkimit ne QKB, te gjitha kontratat e punes se punemarresve te “Erpa Investment” sh.p.k. ne fuqi do te transferohen prane “Fondi Erpa” Sh.p.k, ne perputhje me Nenin 138 dhe 139 te Kodit te Punes. “Fondi Erpa” Sh.p.k do te marre persiper te gjithe kontratat e punes te

Joh
FONDI ERPA
 NPT. 1.51308019 A



punemarresve dhe do te konsiderohet pala pergjegjese per cdo detyrim te pashlyer nga "Erpa Investment" sh.p.k para dates se ekzekutimit.

8. EFEKTE MBI ORGANET DREJTUESE PAS PERTHITHJES

Bashkimi me perthithje nuk do te sjelle asnje ndryshim ne organet drejtuese te "FONDI ERPA" Sh.p.k.

Ne daten e ekzekutimit te bashkimit, Administratori I shoqerise do te jete po Z. Paulin Rranzi.

9. EFEKTET LIGJORE TE BASHKIMIT DHE NDRYSHIMI I EMRIT TE SHOQERISE PERTHITHESE NGA "FONDI ERPA" Sh.p.k ne "ERPA INVEST" Sh.p.k

Sikurse parashikon neni 220, pika 3, e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", regjistrimi i bashkimit teshoqerive prane Qendres Kombetare te Regjistrimit:

- a) ka pasoje kalimin te shoqeria perthithese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe perthithet. Ky transferim ka pasoja si ne marredheniet ndermjet shoqerive, ashtu edhe te palet e treta;
- b) ben qe Ortaket e shoqerise se perthithur te behen Ortake te shoqerise perthithese;
- c) ben qe shoqeria qe perthithet te vleresohet e prishur, ndaj cregjistrohet nga QKB, pa kaluar ne procesin e likuidimit.

Personalitet juridik do te vazhdoje te kete vetem shoqeria perthithese "Fondi Erpa" Sh.p.k e cila do ndryshoje dhe emrin ne "Erpa Invest" shpk

10. MBROJTJA E KREDITOREVE

Kreditorët e shoqerive mbrohen ne perputhje me nenin 221 te Ligjit Tregtar.

11. ZGJIDHJA E PROJEKT-MARREVESHJES

Kjo projekt-marreveshje mund te zgjidhet ne cdo kohe perpara dates se ekzekutimit, me miratimin e dhene me shkrim nga te dyja palet.

Paulin Rranzi
FONDI ERPA
SH.P.K.
NR. 1, STRADA A



12. LIGJI I ZBATUESHEM DHE FORCA MADHORE

Kjo projekt-marreveshje, ne teresi, do te qeveriset nga legjislacioni i Republikes se Shqiperise.

Palet nuk mund te deklarohen pergjegjese per mospermbushjen e detyrimeve respektive, kur kane rene nen ndikimin e nje force madhore e cila ka ndikuar drejtperdrejte ne ekzekutimin dhe mbarevajtjen normale te permbajtjes se kesaj kontrate, per aq kohe sa do te vazhdoje te jene nen ndikimin e kesaj force dhe per aq sa jane ndikuar ne ekzekutimin e detyrimit perkates.

Force madhore do te konsiderohen te gjitha fakte dhe rrethana qe dalin jashte kontrollit normal dhe te arsyeshem te paleve dhe kane ndikuar objektivisht ne zbatimin e kesaj kontrate ose pjeseve te caktuara te saj.

Me perfundimin e periudhes se ndikimit apo efekteve te Forces Madhore palet do te vazhdojne me ekzekutimin normal te kesaj kontrate, sipas permbajtjes.

Do te konsiderohen Force madhore (jo ne menyre shteruese) turbullirat civile, lufta, grevat, shkaterrimet nga katastrofat natyrore, cdo lloj akti ligjor dhe nenligjor miratuar pas nenshkrimet te kesaj kontrate qe ndikon drejtperdrejte ne ekzekutimin normal te kesaj kontrate etj.

13. ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE DHE GJYKATA KOMPETENTE


Palet do te bejne te gjitha perpjekjet per zgjidhjen me mirekuptim te mosmarreveshjeve qe mund te lindin nga ekzekutimi i kesaj projekt-marreveshjeje.


Ne qofte se mirekuptimi sipas paragrafit te pare te ketij neni nuk mund te arrihet, autoriteti kompetent per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

14. TE NDRYSHME


Gjuha: Kjo marreveshje eshte hartuar ne Shqip.

Z. Paulin Rranzi,
Administrator i SHOQERISE "Fondi Erpa" Sh.p.k





Z. Paulin Rranzi
Administrator i SHOQERISE "Erpa Investment" sh.p.k





RAPORTI I ADMINISTRATOREVE

Sot, me date 30.07.2018 ne Tirane, ndermjet paleve te meposhtme:

1. Z. Paulin Rranzi, Administrator i SHOQERISE "Fondi Erpa" Sh.p.k., me NIPT L51308018A,

dhe

2. Z. Paulin Rrazni, Administrator i SHOQERISE "Erpa Investment" sh.p.k., me NIPT L12025001L,

Palet bien dakord per sa me poshte:

Do te kryhet ne formen e perthithjes te dy shoqerive .

A. Informacion per shoqerite qe bashkohen :

- a) SHOQERISE "Fondi Erpa" Sh.p.k. person juridik i organizuar dhe qe vepron ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, me seli ne Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, Pallati 11/1, EGT Tower, Kati 5, Tirane, e regjistruar prane QKB, me NIPT L51308018A, perfaqesuar nga Administratori Z. Paulin Rranzi, ketu e me poshte *Shoqeria Perthithese*; dhe
- b) SHOQERISE "Erpa Investment" sh.p.k., person juridik i organizuar dhe qe vepron ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, me seli ne Njesia bashkiake nr 5, rruga Abdyl Frasheri, pallati 11/1, EGT Tower, kati 5, Tirane, e regjistruar prane QKB , me NIPT L12025001L, perfaqesuar nga Administratori Z. Paulin Rranzi ketu e me poshte si *Shoqeria e Perthithur*.

B. Baza ligjore e raportit

Baza ligjore dhe dokumentacioni mbi bazen e pergatitjes se ketij Raporti bashkimi eshte :

- a) Bilancet kontabel te dy shoqerive per periudhen 2015-2016-2017
- b) Librat kontabel
- c) Inventaret e gjendjes fizike
- d) Aktet e themelimit dhe statutet e te dy shoqerive
- e) Ligji nr.9901 dt 14.04.2008 ``Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ``
- f) Ligji nr 9228 dt 29.04.2004 ``Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare``
- g) Standartet Kombetare te Kontabilitetit

Jak
FONDI ERPA
NIPT L51308018A



C. Aktivet afatshkurter

Ne AASH te shoqerise se perthithur do te perfshihen gjendja e cashit dhe llogarite e likujditetet , gjendja e inventareve dhe kerkesave per arketim me date 01.01.2018.

D. Aktivet afatgjata materiale

Ne AAGJM te shoqerise do te paraqiten te gjitha aktivet e inventarizuara me date 01.01.2018 .

E. Kapitallet e veta

Perkundrejt kalimit te AAGJM dhe AASH do te kemi dhe bashkimin e kapitaleve te shoqerive ne kapitalin e shoqerise perthithese "Fondi Erpa" Sh.p.k. Kapitali I shoqerise perthithese do te jete 586.359.764 leke .

F. Kuotat e ortakeve ne shoqeri

Per shkak te natyres se transaksionit, mungeses se te dhenave te besueshme te riskut te tregut te kapitaleve ne Shqiperi dhe mungeses se referencave per transaksione te ngjashme ne treg, metoda me e pershtatshme per kalkulimin e raportit te kembimit te kuotave te shoqerive te perfshira ne bashkim eshte metoda e Vleres Neto ose ndryshe Vlera Kontabel. Raporti i kembimit te Kuotave percaktohet nga madhesia e perftuar nga pjestimi i vlerave kontabel te Kuotave te dy shoqerive.

	Orataket e dy shoqerive	% e reja	Kapitali
1	EMANUELE BELLANI	1.46%	8,556,096
2	PAULIN RRANZI	48.19%	282,552,498
3	PAOLO DATI	1.46%	8,556,096
4	GIANCARLO FIORANI	2.58%	15,098,994
5	MECAMIDI ITALIA	1.46%	8,556,096
6	PARIEL INVEST S.A	30.69%	179,980,002
7	NOLDEM srl	14.17%	83,059,982
	Totali	100.00%	586,359,764

Jah
Fondi ERPA
NTL VERONIA



G. Detyrimet afashkurtera dhe afatgjata

Te gjitha detyrimet e shoqerise se perthithur do te kalojne ne shoqerine perthithese si pasoje e detyrimeve kontraktuale formale te bera deri me daten kur do te kryhet ky regjistrim per bashkimin me perthithje prane QKB .

H. Emri i shoqerise perthithese

Personalitet juridik do te vazhdoje te kete vetem shoqeria perthithese "Fondi Erpa" Sh.p.k e cila do ndryshoje dhe emrin ne "Erpa Invest" shpk

I. EFEKTET MBI PUNEMARRESIT

Ne daten e regjistrimi te bashkimit ne QKB, te gjitha kontratat e punes se punemarresve te "Erpa Investment" sh.p.k.ne fuqi do te transferohen prane "Fondi Erpa" Sh.p.k, ne perputhje me Nenin 138 dhe 139 te Kodit te Punes. "Fondi Erpa" Sh.p.k do te marre persiper te gjithe kontratat e punes te punemarresve dhe do te konsiderohet pala pergjegjese per cdo detyrim te pashlyer nga "Erpa Investment" sh.p.k para dates se ekzekutimit.

J. EFEKTE MBI ORGANET DREJTUESE PAS PERTHITHJES

Bashkimi me perthithje nuk do te sjelle asnje ndryshim ne organet drejtuese te "FONDI ERPA" Sh.p.k.

Ne daten e ekzekutimit te bashkimit, Administratori I shoqerise do te jete po Z. **Paulin Rranzi**.

K. EFEKTET LIGJORE TE BASHKIMIT DHE NDRYSHIMI I EMRIT TE SHOQERISE PERTHITHESE NGA "FONDI ERPA" Sh.p.k ne "ERPA INVEST" Sh.p.k

Sikurse parashikon neni 220, pika 3, e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", regjistrimi i bashkimit teshoqerive prane Qendres Kombetare te Regjistrimit:

a) ka pasoje kalimin te shoqeria perthithese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe perthithet. Ky transferim ka pasoja si ne marredheniet ndermjet shoqerive, ashtu edhe te palet e treta;

FONDI ERPA
SH.P.K.
NR. 1.150010 A



- b) ben qe Ortaket e shoqerise se perthithur te behen Ortake te shoqerise perthithese;
- c) ben qe shoqeria qe perthithet te vleresohet e prishur, ndaj cregjistrohet nga QKB, pa kaluar ne procesin e likuidimit.

L. MBROJTJA E KREDITOREVE

Kreditorët e shoqerive mbrohen ne perputhje me nenin 221 te Ligjit Tregtar.

Z. Paulin Rranzi,
Administrator i SHOQERISE "Fondi Erpa" Sh.p.k

Paulin Rranzi *Joh* **"Fondi ERPA" Sh.p.k**
NPT: L 51308019 A

Z. Paulin Rranzi
Administrator i SHOQERISE "Erpa Investment" Sh.p.k.

Paulin Rranzi *Joh* **ERPA INVESTMENT**
ERPA INVESTMENT
TIRANE - ALBANIA

15. LISTA E ANEKSEVE

Aneks 1

Vendimet e Asambleve te Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerive “Fondi Erpa” sh.p.k. dhe “Erpa Investment” sh.p.k.

Aneks 2

Pasqyra e Pozicionit Financiar ne Daten e Fundit Kontabel te “Fondi Erpa” Sh.p.k. dhe tre viteve kontabel 2017-2016-2015

Aneks 3

Pasqyra e Pozicionit Financiar ne Daten e Fundit Kontabel te “Erpa Investment” sh.p.k. dhe tre viteve kontabel 2017-2016-2015

Aneks4

Raporti I Auditit ligjor I cili do te japi dhe Bilancin e perthithjes nga shoqeria “FONDI ERPA” Sh.p.k. (shoqeria perthithese).

Aneks 5

Bilanci i celjes se Shoqerise Perthithese “FONDI ERPA” Sh.p.k. ndryshuar tashme ne emrin “Erpa Invest” sh.p.k.

